



---

**E K S T R A K T**

**i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 15.12.2022, duke filluar në orën 10:00**

**Në mbledhje morën pjesë:** Mirsada Behluli, Arton Brahimi, Elmira Nikçi - Rexha, Oktay Kurtesh, Faton Marolli, Kimeta Shok, Nenad Miladinovic.

**Munguan:** Adnan Ajeti dhe Trieria Kasumi - Berisha.

**Në mbledhje morën pjesë edhe :** Alessandro Marino, përfaqësues i KFOR-it, Florent Salihu, përfaqësues nga UNMIK-u, Xhavit Fejza, zyrtar nga UNMIK-u, Klaudia Mula, zyrtare nga ZKKK-ja.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit Mirsada Behluli, kryesuese me këtë

**R E N D D I T Ë S:**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2022;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2023 ;
4. Analizë e përgjithshme e qëllimeve institucionale të Komitetit për Komunitete dhe Zyrës për Komunitete dhe Kthim ;
5. Raporti i ZKKK-së, për muajin nëntor 2022 ;
6. Raportimi nga përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë për gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre;
7. Të ndryshme.

Para se te fillohej me pikat e rendit të ditës z. Miladinovic dha vërejtje lidhur me mos marrjen pjesë të zyrtarit të OSBE-së, në mbledhjet e Komitetit për Komunitete.

#### **Pika e parë**

**Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së**

**Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

#### **Pika e dytë**

**Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2022**

**Njëzëri u miratua Raporti vjetor i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022.**

#### **Pika e tretë**

**Shqyrtimi dhe miratimi i planit vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2023**

**Mirsada Behluli**, kryesuese tha se besoj se materiali i cili ka të bëjë me Planin e punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023, e keni marr dhe e keni lexuar, prandaj shtroj pyetjen se a jeni të pajtimit me këtë plan të punës apo ka dikush të shtoj diçka .

**Njëzëri u miratua Plani i punës së Komitetit për vitin 2023.**

**Nenad Miladinovic**, tha se sa i përket Planit të punës së Komitetit për Komunitete është i përpiluar shumë mirë dhe nuk ka asnjë vërejtje.

#### **Pika e katërt**

**Analizë e përgjithshme e qëllimeve institucionale të Komitetit për Komunitete dhe Zyrës për Komunitete dhe Kthim**

**Mirsada Behluli**, kryesuese lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se të gjithë e dimë se cilat janë qëllimet institucionale të Komitetit për Komunitete, të promovohen të drejtat e komuniteteve, t'i identifikojmë problemet dhe nevojat tek komunitetet përmes drejtorive të Komunës së Prishtinës dhe institucioneve të tjera të Komunës, vizitat në shkolla. Të identifikohen problemet në arsim dhe shëndetësi, të identifikohen rastet sociale, familjet me nevojë të cilat kanë nevojë për materiale për ngrohje, higjienike, ushqimore dhe të gjitha të tjerat çka janë në kompetencë të Komunës.

Në planin dhe programin e punës së Komitetit për Komunitete, kemi kontakt edhe me insitucionet qendrore siç është Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe Zyrën për komunitete pranë kryeministrit.

**Nenad Miladinovic**, tha se sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, mendoj që në Raportin e punës së Komitetit janë përfshirë shumica e aktiviteteve tona që i kemi pasur gjatë këtyre gjashtë muajve. Ai në vazhdim tha se meqë nuk kemi mundur t'i realizojmë të gjithat që i kemi planifikuar, por besojë që në vitin e ardhshëm besoj se do të fillojmë me kohë ti përmbledhim të gjitha vizitat e rëndësishme në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe Zyrën e drejtorit për komunitete pranë kryeministrit.

## Pika e pestë

### Raporti i ZKKK-së, për muajin nëntor 2022

**Klaudia Mula**, tha se sa i përket Raportit të Zyrës për komunitete dhe kthim për muajin nëntor, materialin e keni marr dhe e keni lexuar të gjithë, por unë kisha veqar disa aktivitete me rëndësi që janë ndërmarrë gjatë muajit nëntor;

- Është nënshkruar marrveshja e bashkëpunimit mes CARITAS-in, zviceran për ti ndihmuar rastet e kthyer dhe rastet e cenuara në fushën e riintegrit, si dhe trajnimin në teknologjinë informative për fëmijët e riintegruar në Kosovë;
- Gjithashtu është nënshkruar marrveshja e bashkëfinancimit në mes të Organizatës ndërkombëtare për migrim IOM dhe Komunës së Prishtinës, për projektin multifunksional për shkollën fillore „Naim Frashëri“;
- Kisha bërë një njoftim lidhur me platformën kombëtare për mbrojtjen për diskriminim ndaj komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian;
- Kjo është një platformë ku të gjithë qytetarët mund të raportojnë sjelljet diskriminuese në këtë platformë;
- Një kopje të platformës e kam në gjuhën rome të cilën kam dëshiruar me ia dorëzuar z. Adnan por nuk është prezent, kurse një pllakat është për Fatonin që t'i ngjesin nëpër lagjet e tyre dhe t'i njoftojnë qytetarët se ku mund të raportojnë rastet e diskriminimit;
- Mendoj se është e rëndësishme edhe për qytetarët e tjerë që kanë ku t'i raportojnë rastet edhe janë të dhëna konfidenciale ku vetëm autoritetet përgjegjëse mund ti shohin ato të dhëna.

Ajo në vazhdim tha se është me rëndësi të theksohet se është lansuar strategjia për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, dhe shumë shpejt jemi të obliguar si Komunë e Prishtinës që të hartojmë Planin lokal të veprimit për zbatimin e kësaj strategjie, ku edhe Komiteti për Komunitete është përgjegjës për miratimin e atij plani në të ardhmen, do të jeni të informuar për rrjedhën e këtij plani.

Ndërsa sa i përket aktiviteteve tjera mujore, besoj se i keni lexuar në raport, nëse keni diçka me pyet jeni të mirëseardhur.

## Pika e gjashtë

### Raportimi nga përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë për gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre

**Mirsada Behluli**, kryesuese hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

**Kimeta Shok**, tha se nuk ka diçka të veçantë për të thënë dhe sa i përket sigurisë krejt është në rregull. Ndoshta isha kthyer tek shkollat ku tek shkolla e mesme “Xhevded Doda”, rreth tavanit ende nuk është ndërmarr asgjë dhe tani kur të fillojnë të reshurat mundet të ndodhë që tavanit të ju bie fëmijëve në kokë.

**Mirsada Behluli**, tha se përmes Lindës do ta dergojmë shkresën në drejtorinë përkatëse, se kur është në pyetje siguria e fëmijëve nuk është gjë për tu neglizhuar.

**Nenad Miladinovic**, sa i përket gjendjes së sigurisë tha se duke u bazuar edhe në periodat e mëhershme nuk kemi ndonjë problem. Meqë kemi bashkëpunim shumë të mirë me Policinë, kështu që kjo funksionon shumë mirë, e po ashtu kam disa aktivitete tjera si takime me KFOR-in, për aktivitete të ndryshme.

Isha kthyer pak tek mbeturinat ilegale kisha me u lutur që të dërgohet një shkresë tek Drejtoria e Inspektionit, kurse shkresa tjetër tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, sepse ajo ka marr hov të madh, po reagohet të merren masa me kohë sa nuk është bërë më tepër.

**Oktay Kurtesh**, tha se sa i përket sigurisë nuk kemi problem, por kemi problem në lagjet me kanalizimin e sidomos në rrugën „Ibrahim Lutfiu“, „Nazim Gafuri“ dhe në rrugën kryesore „Bajram Kelmendi“. Ai njëherit shprehi edhe shqetësimin lidhur me mbeturinat.

**Faton Marolli**, tha se sa i përket sigurisë nuk kemi problem, mirëpo ai ceki se prej kohës se kur ka qenë prezent drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ku pej asaj dite e kam dorëzuar kërkesën në emër të qytetarëve për vendosjen e pengesave në rrugën „Bedri Gjini“ dhe në rrugën „Caraleva“. Ai në vazhdim tha se aty ka qenë edhe vet kryetari prezent dhe është vrëtetuar me gjendjen si është që vërtet qytetarët në atë pjesë janë të rrezikuar prej vozitjes së shpejt të automjeteve.

Ky problem është qe 3-4 muaj, pra është një kërkesë shumë urgjente sa që jam i detyruar të dorëzoj edhe një petition për herë të dytë se vërtet është shqetësuese.

**Mirsada Behluli**, kryesuese tha se ne këtë shqetësim e kemi cekur edhe në Raportin gjashtë mujor të punës së Komitetit, mirëpo do ta përcjellim edhe në Kuvend.

Ndërsa sa i përket gjendjes së sigurisë tek komuniteti boshnjak tha se nuk ka kurrfarë problemesh, mirëpo kisha me e ngritur shqetësimin mbi deponinë e mbeturinave në lagjen „Kalabria“, rruga „Sylejman Vuçitërna“, ku kontejnerët janë gjithnji përplot me mbeturina.

Tek Kolektori ka kontjenerë të cilat janë përplot me mbeturina dhe përreth ka deponie të mbeturinave me orendi, mobilje por çka është më e keqja se kur kalohet nga rruga kryesore i jap një pasqyrë shumë të keqe.

Ajo në vazhdim tha se shumë herë kam kërkuar që ata kontjenerë të largohen nga rruga kryesore, sepse ka aromë shumë të keqe e cila kundërmon.

**Pika e shtatë**  
**Të ndryshme**

**Nenad Miladinovic**, meqë po afrohet fundi i vitit, uroj që në vitin e ardhshëm takimet tona të vazhdojmë sikurse sot, po dëgjojmë propozime, kritika pra me këtë ton të na shkojnë takimet e ardhshme.

Tani të gjithë juve dhe familjeve tuaja ju uroj shëndet dhe çdo të mirë për vitin e ri.

*Mbledhja mbaroi në orën 12:30*

**Procesmbajtësja**  
**Lendita Spahija**

**Kryesuesja e Komitetit**  
**Dr. Mirsada Behluli**



Faqe 4 nga 4